




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, indo.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Procesverbal

Nga seancën e **X (dhjetë)** të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, mbajtur më 26.11. me këtë:

R E N D P U N E

1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,
2. **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**
 - 2/1. Raporti financiar nëntë mujor 2012,
 - 2/2. vendimi për lejin e transferit dhe harmonizimit të Propozim-mjeteve financiare
 - 2/3. Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për raste sociale,
 - 2/4. Propozim vendimi për uljen e tarifës mbi qiranë për shfrytëzimin e lokalit afarist (Bodrumi-Tombola) në Gjilan
3. Të ndryshme,

Seanca i filloi punimet në ora 10.00

Kryesuesi i Seancës
Izmi Zeka

Në punimet e Seancës së dhjetë (X) morën pjesë:

Kryetari i Komunës, z. Qemajl Mustafa
Anëtarët e Kuvendit

Përfaqësuesi i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, z. Fazli Abdullahu
Përfaqësuesi i Forumit Demokratik "Anamorava", z. Isa Shefkiu

Përfaqësuesi i OSB-së , z. Basri Sejdiu
Përfaqësuesi i Shoqërisë Civile, Shaban Terziu
Përfaqësuesja për Barazi Gjinore zonja, Dritë Klaiqi

Seancën e dhjetë e hapi dhe udhëhoqi, kryesuesi i Kuvendit, z. Izmi Zeka i cili i përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë dhe kërkoi që të verifikohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit në punimet e seancës së dhjetë.

1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,

Nga ana e sekretarisë u vërtetua se në punimet e seancës së dhjetë ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit (41).

Procesverbal nuk pati vërejtje dhe u aprovua me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit.

Pas konstatimit të prezencës, kryesuesi i Kuvendit e hapi debatin, pasi që kishte kuorum duke kërkuar nga anëtarët e Kuvendit që të deklarohen se a pajtohen me rendin e punës?

Mirëpo, kryesuesi i bërë ftesë të gjithë të pranishmëve në sallë që të marrin pjesë në promovimin e Monografisë së Gjilanit, po në këtë sallë sot në ora 18.00. Ju e dini se ka një kohë të gjatë që ne e kemi zgjedh një Këshillë për hartim të kësaj Monografie i cili këshill ka punuar një kohë të gjatë, prandaj sot me rastrin 100 Vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë do të bëhet promovimi.

Sokol Haziri- unë së pari të gjithë anëtarëve të Kuvendit dhe të gjithë qytetarëve të Gjilanit nga kjo sallë ia uroj 100 Vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë duke dëshiruar që këtë festë ta kremtojmë në mënyrë sa më dinjitoze!

Ndërsa sa i përket Monografisë, unë kërkoj që të mos nxitojmë, sepse unë mendoj se kjo Monografi ende duhet të filtrohet dhe përpunohet, sidomos për disa lëmi të caktuara. Nuk duhet të nxitojmë dhe të dal një dokument jo në nivel të duhur shkencor, por të jetë një libër i cili do t' i qëndrojë kohës për një periudhë të gjatë.

Arben Mehmeti- edhe unë pajtohem me shefin e grupit të AAK-së përkitazi me Monografinë, sepse siç po shihet ky dokument ka dal aksidentalisht në shpejtësi për t' u aprovuar (promovuar) i cili është një dokument shumë i rëndësishëm dhe nuk mendoj se në formën çfarë e kemi planifikuar ne mendojmë se është herët për t' u bërë, sepse është shumë i mangët dhe është jo në harmoni me kërkesat reale. Promovimi i kësaj Monografie është çështje politike dhe ne nuk do të jemi përgjegjës për mangësitë e këtij dokumenti.

Sa i përket rendit të ditës, unë po e përsëris për të katërtën ose pestën herë që kem bërë një kërkesë e cila deri më tani nuk është realizuar ajo kërkesë e jona. Kjo kërkesë është edhe një shkelje e premtimeve publike nga ana e kryesuesit të Kuvendit e cila kërkesë ka qenë dhe është për transmetim të drejtpërdrejtë të seancave

Gjithashtu në seancën e kaluar kemi pasur një kërkesë për një informatë lidhur me punimet që po ndodhin në Bibliotekë të qytetit e cila kërkesë është e evidentuar edhe në procesverbal që në seancën e radhës që të na sillet një informatë e tillë.

Po ashtu e kemi kërkuar edhe një informatë për Mirëmbajtjen verore të rrugëve, por as kjo nuk na është sjell në këtë seancë.

Mandej kërkojmë një informatë nga DA lidhur me disa një eksese që kanë ndodhur në Shkollën Filllore “Thimi Mitoko”. Në këtë shkollë nuk është vetëm një eksese, por është në varg i ekseseve të tilla, prandaj kërkojmë informatë për këto raste.

Mandej kërkojmë edhe një informatë lidhur me zgjedhje e brendshme të PDK-së të cilat janë duke u mbajtur këto ditë?

Izmi Zeka- të gjitha çështje të cilat u kërkuar në seancën e radhës në dhjetor, drejtorët i sjellin informatat me shkrim dhe e hapim debatin.

Tahir Arifi- unë nuk desha të hap debat lidhur me Monografinë, por desha të jap disa përgjigje dhe të them se Monografia nuk është çështje politike dhe nuk duhet të politizohet, sepse kjo Monografi i ka kaluar të gjitha procedurat dhe nuk besoj se ka ndodhur kështu me asnjë libër në Kosovë. Janë marrë të gjitha vërejtjet nga qytetarët dhes sot është një dokument final, por nëse ka vërejtje dhe lëshime ky dokument ka mundësi dhe duhet të ribotohet në ndonjë rast tjetër, sepse e përkryer nuk mund të jetë asgjë.

Sabedin Kadriu- unë kam propozim për një pikë të rendit të punës: aty ku është propozim-vendim për uljen e qirasë për lokalet afariste e cila pikë është e destinuar vetëm për një lokal, unë si këshilltar propozoj që të diskutohet dhe për të gjitha lokalet dhe të ulet tarifa, sepse sipas mendimit tim popullata gjendet në një gjendje të rëndë e ekonomike në tërësi në Gjilan dhe Kosovë dhe konsideroj se ka qenë një ngritje e madhe përnjëherë. Askund në botë nuk ka rritje për 100% ose 200%, por të duhet të shkojë gradualisht duke e vlerësuar gjendjen financiare të njerëzve që i shfrytëzojnë ato lokale.

Prandaj unë propozoj vlerësim për këtë pikë të rendit të punës nëse aprovohet me shumicë nga anëtarët e Kuvendit.

Sadudin Berisha- edhe pse nuk është në rend pune, sot u diskutuar rreth Monografisë dhe po shihet se ka qëndrime të ndryshme. Unë vetëm dy fjali do t’ i them. Në debatin e organizuar për këtë çështje e kam thënë se periudha 1989- 2001 kur janë mbajtur zgjedhjet e para komunale dhe nacionale nuk është përfshirë kjo periudhë ose është përfshirë shkarazi për pa i dhënë asnjë vlerë historike asaj periudhe.

Unë e di se është formuar një grup në ndërkohë, por edhe ajo pjesë nëse është bërë diçka është bërë me subjektivizëm të skajshëm, Do të ishte shumë keq për punën dhe angazhimin e të gjithë qytetarëve, institucioneve dhe subjekteve politike të asaj periudhe që të mos përfshihet dhe do të jetë një pasqyrë shumë e zbehtë lidhur me atë se çka ka ndodhur në Gjilan. Për këtë arsyeje ajo Monografi është tepër e mangët dhe nuk po them e politizuar, por skajshmërisht e politizuar.

Arben Mehmeti- lidhur me rendin e punës ne kërkuam një informatë për Bibliotekën dhe Mirëmbajtjen verore të rrugëve, por dy çështje janë më me rëndësi si: rasti në Shkollën “Thimi Mitko” dhe zgjedhjet në PDK.

Ejup Haziri- lidhur me zgjedhjet në PDK, nuk po e kam të qartë se z. Arbeni e kërkon si projekt model, apo pse po i duhet? Ta dimë si t’ia sjellim raportin?

Elisah Ymeri- unë desha t’ia kujtoj Arben Mehmetit se dhe veteranët e luftës tash po pajisen me kartela dhe po regjistrohen dhe desha ta pyes se si e ka marrë një kartelë të tillë shkarazi! Unë desha t’ia uroj!

Arben Mehmeti- përgjigja ime është se librezë nuk kam marrë, por jam shumë më veteran se një pjesë e madhe që janë aktualisht. Edhe familjarisht dhe me të gjitha dëshmitë që duhet të jetë një veteran. Nuk e kam blerë librezën dhe as që dua ta blej, por dua që mbi bazën e kontributit ta bëjë një kërkesë dhe ta vlerësojnë se kush duhet të jetë veteran. Unë librezë ende nuk kam marrë, por keni marrë ju dhe tregoni se ku i merrni?

Izmi Zeka- Monografia po bëhet për herë të parë në Gjilan dhe mund të them e nivelit shkencor. U tha se gjithmonë mbetet për t’u dëshiruar dhe për t’u shkruar edhe më mirë dhe gjithmonë mbetet dikush i pakënaqur, por për këtë Monografi janë marrë preferencat e debateve dhe debatit publik.. Duhet ta dini se libri shkruhet sipas parimeve shkencore dhe jo si dëshirojmë ne. Të gjitha gjërat kanë qenë në kontinuitet dhe janë përfshirë ato të cilat ka pasur mundësi duke i marrë parasysh edhe vërejtje të cilat janë bërë në debat. Nuk duhet të pretendojmë se ajo do të jetë e përsosur, por është një hap i cili po e krijon një mundësi për ta pasur një Monografi të Gjilanit e cila nuk ka ekzistuar kurrë. Është e pamundur të mos ketë ndonjë lëshim, sepse monografitë kanë punë të rënda për t’i hartuar. Unë mendoj se është bërë një punë kolosale për një periudhë 3-4 vjeçare dhe sot promovohet për festat e nëntorit. Unë i përgëzoj të gjitha ata që kanë bërë punë dhe janë angazhuar dhe me këtë punë na del një libër modest për Komunë të Gjilanit. Me këtë libër e kemi mundësinë për ta njohur më mirë historikun e Gjilanit.

Qemajl Mustafa- çështja e Monografisë nuk kisha dëshiruar që të jetë temë në seancë të Kuvendit, sepse ne kur e kemi themeluar Këshillin pas asaj idesë që të hartohet monografia kemi qenë shumë të kujdesshëm që këshilli të jetë gjithëpërfshirës në dy kuptime. Të jetë gjithëpërfshirës para së gjithash profesionalisht dhe janë marrë emrat më eminent shkencor, akademik të Gjilanit dhe Anamoravës dhe në kuptimin politik në mënyrë që edhe politikisht të jetë mirë e balancuar për të mos pasur keq interpretime për shkak të mos prezencës së ndonjë grupi politik. LDK-ja si PDK-ja dhe si AAK-ja të gjithë aktorët të cilët atëherë kanë qenë me relevantë në skenën politike të Komunës dhe Shoqëria Civile është e përfaqësuar në Këshill.

Ne e patëm debatin publik dhe unë e di që këshilli me shumë tolerancë e ka mundësuar krijimin e një trupe të vogël dhe Sadudini është njëri prej tyre së bashku me Basri Musmuratin dhe ndonjë tjetër për rishqyrtimin e asaj periudhe dhe rishkrimin e asaj periudhe dhe dhënien e një kontributi. Unë sa e di ai kontribut ka ardhur dhe është aty!

Debati për Monografinë ka përfunduar, kurse tash e them me shumë përgjegjësi se është mungesë kulture edhe individuale dhe grupore nëse fillojmë për ta kritikuar sot. Monografia është në përmbyllje, sot vijnë 20 ekzemplarë vetëm inaugurues, sepse është shtyp digjital që t' i kemi në vigjilje të festës së Flamurit. Ne e kemi edhe një rast që të shohim vetëm teknikisht mos është bërë ndonjë lëshim në mënyrë që ta dorëzojmë në shtyp dhe pas dy-tri jave do t' i kemi ato 700 apo 1 mijë kopje të Monografisë dhe do t' i kemi të gjithë në dorë.

Debati kritika për Monografinë fillon prej asaj dite kur Monografinë ta kemi në dorë, kur secili ka mundësi në zyrën e tij në shtëpinë e tij për ta lexuar dalëngadalë për ta shënuar ndonjë vërejtje ose kontribut për botimin e ardhshëm i cili ndoshta mund të jetë edhe pas një viti ose në ndonjë kohë optimale të mundshme për ta korrigjuar edhe ndonjë mangësi.

Lidhur me tarifat është në debat Rregullorja mbi gjobat, mbi ngarkesat dhe tarifat dhe ajo do të vijë në një seancë të ardhshme për miratim në Kuvend. Kjo është e veçantë, sepse është një podrum (është tash bastore) dhe qëndrimi është që mos të jetë e Dritës, por të jetë e futbollit dhe që Drejtoria për Financa ta kontrollojë afarizmin në këtë bastore në mënyrë që të ardhurat që mbesin t' i shkojnë barabarsisht futbollit dhe klubeve të tij dhe ta kthejmë në normën ku ka qenë.

Ju lus që ta marrim një vendim edhe atë retroaktivisht, sepse këta nuk kanë arrit për të bërë pagesë prej 1 janarit 2012.

Në Shkollën “Thimi Mitko”, ka ndodhur një ekskes, ka kulmuar me një ekskes me një relacion jo i mirë që nga fillimi i një grupimi prej 2-3 personave me drejtorin aktual të shkollës. Ky fërkim ka ndodhur për shkaqet e të cilit do të mësoni një informacion të cilin drejtori i DA-së e përgatit. Kryesorja mos të jeni në nivel të spekulimeve.

Është një fërkim në mes një arsintari dhe drejtorit dhe në për këtë fërkim në ambientin shkollor, kemi marrë vendim për suspendim. Lënda kalon në komisionin disiplinor i cili e shqyrton dhe merret një qëndrim.

Arben Maliqi- unë së pari po e shfrytëzoj rastin në prani të medieve, por pasi qenka edhe TV “vali”, shfrytëzoj rastin që në emër të grupit tim të gjithë shqiptarëve kudo që janë t' ia uroj 100 Vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë.

Mirëpo për të vazhduar më tepër në këtë seancë e kam një kërkesë e cila kërkesë vije nga qytetarët e lagjeje sime, sepse ju e dini rastin e një ngjarje e cila ka ndodhur në “Dardani” afër Çerdhes “Ardhmëria II” ku një automjet transportuesi i goditi disa makina, por për fat të mirë nuk pati viktima, prandaj është mirë që urgjentisht Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me policinë që të ndërmerr masa dhe aty të vendos policët e shtrirë ose në kohën kur dalin fëmijët nga kjo çerdhe aty të jenë të pranishëm policia rrugore. Është mirë që këtë ta keni parasysh, sepse tash kemi hyrë në stinë të dimrit dhe rreziqet janë më të mëdha. Kjo ishte një kërkesë e qytetarëve të kësaj lagjeje?

Sadudin Berisha- unë nuk desha ta marrë fjalën rreth Monografisë, por kryetari e tha se ndoshta kjo është mungesë e kulturës! Unë po theksoj se mungesë e kulturës është kur nuk dëgjohet zëri i të tjerëve.

E dyta u përmend se është formuar një grup prej tre personave në mesin e të cilëve kinse jam edhe unë? Unë nuk kam informacion për këtë! Unë kam dëgjim, unë e kam

ofruar fjalën dëshmuese për periudhën 1999-2001 dhe i kam ofruar materialet dëshmuese origjinale se çka ka ndodhur gjatë asaj periudhe.

Thënë thjeshtë se kinse është formuar një grup i tillë për të shkruar për këtë periudhë, por ky grup kurrë nuk është thirr dhe nuk është bërë debat për atë periudhë. Unë po theksoj se me shumë papërgjegjësi iu është qasur grupi përgjegjës për shikimin e historisë së kësaj periudhe për hartim të Monografisë.

LDK nuk është kurrë kundër Monografisë, nuk ka qenë kurrë dhe asnjëherë nuk do të jetë, por kërkon që të shkruhet dhe thuhet ajo që ka ndodhur.

Qemajl Mustafa- ka qenë Lirie Kajtazi që nga dita e parë anëtare të Këshillit, mandej ka qenë Fehmi Rexhepi i cili është anëtar Këshilli në qendër nëse nuk gabo. Kërkoni përgjegjësi tjetër kundër z. Sadudin, sepse adresën e keni të gabuar. Kërkoni përgjegjësi të njerëzit tuaj të cilët kanë qenë pjesë e Këshillit që nga fillimi. Ai që ankohet, ankohet në mos punën e tij dhe këtu nuk ka asgjë tjetër.

Izmi zeka- kush është për këtë rend të punës?

Aprovohet rendi i punës me 24 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët nuk u deklaruan.

Sabedin Kadriu- unë e kam një vërejtje të sinqertë dhe po përpiqem të jem shumë demokratë, po si po shihet demokraci nuk ka?

Ne këtu jemi këshilltarë të KK-së dhe këtu edhe kryetari i Komunës dhe këshilltarët kanë të drejtë për të propozuar ndonjë pikë të rendit të punës dhe këshilltarët janë ata të cilët e aprovojnë propozimin ose nuk e miratojnë?

Mos të del këtu që kryetari i Komunës thotë nuk bënë dhe ajo nuk do të thotë se kryetari i Komunës mund të bëjë çka të dojë në Gjilan. Kur propozoj diçka dhe kam propozuar edhe më herët, kërkoj që ajo të paraqitet në Kuvend, mirëpo a e aprovon ky Kuvend apo jo është e drejtë e këtij Kuvendi. Kryesuesi e ka obligim moral që propozimin tim ta hedh në votim!

Izmi Zeka- Rregullorja e punës së Kuvendit është duke u përpunuar dhe kjo ishte arsyeje pse unë nuk u ndal për të debatuar dhe unë jam i pakënaqur me këto gjëra.

Ne bashkërisht do t' i propozojmë në Kuvend dhe do t' i aprovojmë. Është e vërtetë se secili këshilltarë ka të drejtë të propozoj të cilat propozime duhet të hedhen në votim.

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

2/1. Raporti financiar nëntë muor -2012

Izmi Zeka- të gjithë anëtarët e Kuvendit, raportin nëntë muor për vitin 2012 e kanë marrë me shkrim të cilin kanë pasur mundësi që ta lexojnë, por është debatuar edhe në KPF, prandaj më parë t' i dëgjojmë vërejtje dhe propozimet dhe pyetjet e tyre, kurse në fund përgjigjet drejtori i Financave.

Zijadin Maliqi- unë po i them disa gjëra edhe pse këto raporte janë bërë bukur të shpeshta në të cilat po japim vërejte dhe po bëjmë pyetje, për të cilat vërejtje po kemi premtime se do të marrim përgjigje, kurse ato nuk po i marrim asnjëherë!

Unë në këtë raport do të përqendrohem në kategori të hyrave dhe në kategori të shpenzimeve dhe si shihet nga raporti të hyrat e realizuara për këtë nëntë mujor sipas Drejtorisë janë 93.22%. Unë i kam dhënë vërejtjet edhe më parë dhe për mua kjo përqindje nuk bën të jetë kështu dhe po e them se për mua duhet të jetë 73% e buxhetit të përgjegjshëm. Po e përmendi edhe njëherë se planifikimi nuk bëhet për muaj, por bëhet për periudha vjetore. Sipas raportit planifikimi është për 7% më pak se sa është i planifikuar, kurse në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar është diku për rreth 13% më pak. i cili fakt është mjaft brengosës.

Shihet nëpër disa kategori të hyrave ka realizim edhe mbi atë çka është planifikuar, kurse te një pjesë e kategorive të hyrave kemi mosrealizim dhe atë në disa kategori ka mbetur mjaft larg nga ajo çka është e planifikuar, çka do të thotë se nuk e kam të qartë për çfarë arsyeje ka ndodhur kjo? E njëjta është edhe kur e bëjmë krahasimin me vitin 2011, sepse te disa kategori të hyrave kemi rënie shumë të madhe të hyrave. Sa i përket shpenzimeve te pagat i kemi diku në bazë të planit të shpenzuara 66.7% dhe nuk e kam të qartë në këtë kategori a janë 9 muaj apo 8 në këtë raport? Nëse janë 9 muaj paraqitet një tepricë e mjeteve te pagat. Te mallrat dhe shërbimet në bazë të planit shihet se ato me 9 mujor janë shpenzuar qind për qind, por edhe 270 mijë euro janë transferuar për arsim (për mallra dhe shërbime) në fillim të vitit, në muajin e dytë. Në këtë kategori nuk ka më asnjë cent dhe e tërë ajo çka do të punohet pas këtij nëntë mujori mbesin obligime për vitin tjetër.

Te komunalit është gjendja mirë në kuadër të planit, te subvencionet ka diçka më tepër të shpenzuara, por besoj që në këtë periudhë ndoshta reduktohen në një masë të vogël.

Tek investimet kapitale shihet se janë shpenzuar diku afër 87% të mjeteve.

Sa u përket shpenzimeve analitike nëpër kode edhe më tutje vazhdohet ne shpenzime bukur të mëdha nëpër disa njësi buxhetore të cilat unë shkurtimisht po i theksoj e të cilat janë: janë shpenzimet brenda vendit që janë diku për 10 herë më të mëdha se sa periudha e njëjtë e vitit të kaluar. Nuk e kam të qartë a ka ndodhur ndonjë gabim apo është se saktë? Për këtë kategori të udhëtimeve brenda vendit janë diku mbi 174 mijë euro, kurse në të jetën periudhë të vitit të kaluar kanë qenë diku pak shumë se 18 mijë euro. Kërkojmë sqarim a është ashtu apo ka ndodhur ndonjë gabim teknik?

Gjithashtu edhe për shpenzime jashtë vendit ka shpenzime të mëdha, diku mbi 33 mijë euro, por janë edhe 8 mijë euro mëditje për këtë qëllim dhe gjithsej në këtë kategori janë shpenzuar mbi 40 mijë euro. Mirëpo ne asnjëherë nuk po informohemi në Kuvend se ku po bëhen këto udhëtime dhe për çfarë qëllimi?

Mandej te shpenzimet e telefonit së bashku me valën dhe fiksin del një shumë prej 50 mijë eurove e cila shumë është mjaft e madhe!

Shërbimet tjera kontraktuese është mirë njëherë e përgjithmonë të njoftohemi për këtë kategori të shpenzimeve, sepse këtu kemi mbi 375 mijë euro shpenzime.

Furnizim me ushqim dhe pije janë mbi 63 mijë euro të cilat i kam ndarë dhe 41 mijë e 200 euro janë për arsimin parashkollor, por aty thuhet edhe te administrata e të cilat shpenzime e kam kuptuar se janë për konviktin, por janë edhe 22 mijë euro të tjera për ushqim dhe pije. Te drekat zyrtare në krahasim me vitin e kaluar kemi një zbritje

të tyre, prej 80 mijë në 60 mijë euro, por nëse ia shtojmë edhe 22 mijë euro në atë kodin tjetër përsëri e kalon atë shumë.

Te investimet kapitale janë paraqitur në pika të trasha disa punët e cilat janë kryer, por te asfaltimet e rrugëve janë 1 milion e 400 mijë euro, por nuk jemi të njoftuar se cilat rrugë janë tenderuar dhe janë asfaltuar? Nuk e kemi të qartë a është fjala për asfaltim të rrugëve të më parme dhe shlyerja e borxheve gjatë këtij viti dhe si është gjendja?

Kërkojmë që të na sqaroni se ku kemi arrit me pagesën e borxheve a jemi afër?

Është mirë që ne si Kuvend ta dimë sa kemi borxhe, sepse në mjete të informimit po ka informata të ndryshme.

Sokol Haziri- ne e dimë se kapacitetet buxhetore të Komunës janë këto dhe ato nuk janë të dëshirueshme sikur që kemi dëshirë të jenë. Mirëpo kishim dëshiruar që grandet qeveritare ka qenë problematike dhe kanë munguar në Komunë. Mirëpo sidoqoftë me atë që kemi duhet të luftohet, por vërejtjet tona janë kryesisht te ato që i tha kolegu Zijadini të cilat parimisht i mbështesim, por shpenzimet kapitale në qytet nga buxheti i Komunës nuk shpenzohen njëjtë dhe disa pjesë nuk bën të harrohen. Unë konkretisht e kam fjalën për “Dheun e Bardhë”, konkretisht në Lagjen e Banjës, ku është investuar diçka, por pjesa e epërme ka mbetur për pa ia shtrirë fare dorën pushteti. Ka edhe shumë raste të tilla të cilat unë nuk po i përmendi, por do të ishte mirë që brenda mundësive të orientohemi si Qeveria Komunal dhe ajo Qendrore të mirat t’i orientoni në mënyrë proporcionale për të gjithë qytetarët e Komunës.

Çështja tjetër për neve brengosëse janë edhe borxhet. Unë kam informacione të cilat nuk do t’i bëj publike se ka kompani të cilave iu ka Komuna borxh dhe të cilat rrezikohen që t’i humbin edhe pasuritë e tyre, sepse kanë hyrë në kredi dhe nuk kanë mundësi ta shlyejnë borxhin. Kjo është shumë e keqe nëse biznesi jo që fiton por humb nga obligimet e Komunës. Ndoshta nuk është informatë e konfirmuar, por mendoj se borxhet duhet të shlyheshin më herët.

Kemi edhe një vërejtje, sepse është një shifër të konsiderueshme për udhëtime brenda vendit e cila shifër është shumë e papërbalueshme dhe unë besoj që të jetë gabim kjo.

Sidoqoftë ne në parim do të kemi dëshirën që investimet kapitale të shtrihen proporcionalisht në të gjitha lagjet e Gjilanit.

Shkëlqim Latifi- mua më bëri përshtypje fjala e drejtorit i cili theksoi se do t’i marrin mëditjet të gjithë ata që kanë qenë anëtar të komisioneve. Mirëpo edhe unë kërkoj një informacion që se kush janë këta anëtarë, mandej sa mjete janë ndarë për këto komisione? Ajo që më shtyri që ta ngrit këtë problematikë është se është se ka mjete për kompensim të komisioneve, kurse në anën tjetër ka disa mësimdhënës të cilët vazhdimisht ankohen, sepse nuk i kanë marrë pagat që nga viti i kaluar.

Kërkoj nga Drejtoria e Financave që t’i jep përparësi edhe kësaj problematike.

Arben Maliqi- ne si grup në parim e mbështesim raportin financiar, por më duhet t’i bëjë disa krahasime kur bëhet fjalë për realizmin e të hyrave vetanake për të cilin kod kërkoj një koment dhe e bëj një pyetje për drejtorin; pse është ai dallim kaq i madh në vlerë prej mbi 300 mijë euro në mes vitit të kaluar 2011 dhe këtij viti 2012? Ku është

shkaku i këtij dallimi? Mandej gjobat në trafik dhe gjobat e gjykatave kanë një ngecje, prandaj e lus drejtorin që të na jep sqarime.

Mandej kemi ngecje te regjistrimi i automjeteve, kur dihet se në Kosovë, por edhe në Gjilan, secila shtëpi i posedon 3-4 automjete. Duhet ditur se për çfarë arsye kemi ngecje? A nuk po i regjistrojnë qytetarët automjetet apo është në pyetje diçka tjetër?

Unë kam informacione se qytetarët po i marrin vërtetimet edhe në komuna tjera si është ajo e Novo Bërdës. Mandej te shpenzimet kapitale dihet se procesi i decentralizmit disa fshatra i ka shkatërruar tërësisht dhe i ka larguar për 30 km dhe për këtë arsyeje fshati Kosaq ka mbetur pa asfalt i cili është i vetmi fshat në Komunë të Gjilanit (por tash nuk është as me Barilvë, as me shehër” dhe është i vetmi fshat pa asfalt. Është mirë që të ndërmerret ndonjë hap që 1 km asfalt të asfaltohet.

Mandej është një rrugë në lagjen time “Dardania I”, rruga e VII e cila është e degraduar tërësisht dhe është mirë sa më parë që të ndërmerret diçka

Në parim ne e mbështesim këtë raport dhe besoj se kjo qeveri në një afat sa më të shkurtër do t’i plotësojë këto kërkesa tona.

Bahrie Veseli- unë lidhur me raportin më tepër i kam disa pyetje përkitazi me disa shifra të cilat nuk kam pasur mundësi t’i kuptoj.

Kodi 13509- thotë akomodim zyrtar dhe udhëtim. Ishte një shifër e madhe të cilën e përmendi Zijadini.

Pajisje të tjera është një kod, por nuk e kam të qartë për çka është fjala këtu?

Mandej është kodi tjetër 13620 në të cilin thuhet ushqim dhe pije e cila shumë është mbi 467 mijë euro

Kodi 14023- nuk e kam të qartë se çfarë shpenzimi është bërë në shumë prej mbi 78 mijë euro?

Kodi 13130- mallra dhe shërbime, por nuk dihet se për çfarë kategorie është fjala

Te shpenzimet e telefonisë është një shpenzim i tepërt.

Kodi 13450- shërbime shtypje jo markentig. Për çka bëhet fjalë dhe për çka janë bërë këto shpenzime?

Te mirëmbajtja e objekteve shkollore e kemi një shifër prej 76 mijë eurove, kurse për ushqim dhe pije janë harxhuar 46 mijë euro. Këtu shihet sa po i japim rëndësi ne mirëmbajtjes së objekteve shkollore. Kur e dimë se sa buxhet kemi e sugjeroj udhëheqjen komunale që ta menaxhojë më mirë buxhetin.

Gjithashtu i sugjeroj Kuvendit dhe Drejtorisë së Financave që arsimtarët të cilët udhëtojnë ta bëjnë subvencionimin e udhëtimit, sepse unë e di që me rregullore, arsimtarët të cilët udhëtojnë mbi 5 km duhet t’iu bëhet ky subvencionim.

Pyetja e fundit është pse disa mësimdhënës ende nuk kanë marrë 5-6 paga?

Arben Mehmeti- në emër të grupit i ka thënë gati të gjitha gjërat Zijadini, në aspektin gjeneral, por ne tash do t’i themi disa gjëra më të imta.

Sa i përket raportit financiar unë kërkoj një informatë pasi është kryetari këtu dhe kjo është çështja e projekteve të papërfunduara në Komunë të Gjilanit.

Unë nga ajo që kam parë në parim e mbështesë qëndrimin e z. Maliqi dhe mirë është që të trajtohet edhe më mirë çështja. Në kuadër të kësaj unë nga praktika e kam një pyetje lidhur me atë për mirëmbajtjen e rrugëve i cili aktivitet është aktual. Në pjesën ku unë jetoj në “Arbëri” në atë lagjeje janë hapur gropat, rrugët janë prerë dhe kjo ka

ndodhur gati para një muaji. Këtu pengohet lëvizja e lirë e qytetarëve dhe nga komunikimi që kam pasur me zyrtarët e Drejtorisë për Shërbime Publike është thënë se ka probleme të financave, kurse rrugët janë prerë, kurse kompania nuk mund t' i kryejë e punët e shumë telashe të tjera. Do të ishte mirë që të epet një sqarim edhe nga kryetari për këtë rast për ta pasur edhe ne një arsyetim tonin si anëtarë të Kuvendit dhe të dimë se çka t' i themi qytetarëve.

Në kuadër të kësaj e kam edhe atë të ndriçimit publik dhe po shihet se në qendër të qytetit ka filluar ndriçimi publik dhe një informatë e kam pasur më herët se ky ndriçim do të bëhet mbi selinë e LDK-së, kurse tash është ndalë diku nën seli të LDK-së.

Nuk e kam të qartë pse ka ndodhur kjo a është problemi financiar, apo është moszbatim i projektit të mëhershëm? Kjo për neve është shqetësuese dhe nuk e dimë se ku qëndron problemi?

Gjithashtu kemi pasur edhe kërkesa të tjera për lagjen “ Arbëria” që të rregullohet problemi i ujit i cili premtim na është dhënë edhe nga drejtori dhe kryetari, por ende nuk ka ndodhur kjo! A është edhe këtu problemi financiar apo çka po ndodh?

Si pyetje e fundit për drejtorin; në këtë nëntë mujor Komuna e Gjilanit sa ka borxhe për punët që kanë përfunduar në këtë periudhë? Në të kaluarën kemi mbet për marrë përgjigje sa i përket edhe asfaltimit të disa rrugëve. Nga informatat që i kam e që janë të sakta janë disa rrugë që janë ndërtuar si është lagjja në drejtim të Cernicës në të cilën rrugë është shtruar një shtresë e asfaltit, por ka mbetur për pa ushtruar edhe një shtresë tjetër. Është lagjja tjetër që del tek Universiteti “Fama” në të cilën rrugë ka ndodhur ashtu, është shtruar një shtresë, kurse tjetra jo! Gjithashtu ka ndodhur edhe me Livoçin e Poshtëm ku është shtruar një shtresë dhe pjesa tjetër nuk është shtruar.

Raste të tilla mund të ketë edhe në vende të tjera, por unë i përmenda vetëm këto sa për ilustrim. Kjo tregon se kemi të bëjmë me realizim jo të plotë të projekteve, por me realizim të gjysmë projekteve. Të na sqarojë drejtori se ku është problemi i moszbatimit të këtyre projekteve deri në fund? A është problemi financiar apo ato do të mbesin kështu? Me projekt është paraparë për t' u shtrirë dy shtresa të asfaltit, por kjo nuk ka ndodhur të cilin argument mund ta vërtetojmë edhe sot nëse dëshirojmë.

Është mirë të na sqarohet pse ka ndodhur kjo dhe kur do të përfundojnë këto projekte? Gjithashtu kemi edhe ulje të inkasimit në raport me vitin 2011, kemi ngecje nga të hyrat e lejeve të ndërtimit, prandaj ne duhet ta dimë se për çka ka ndodhur ky inkasim i dobët?

Abdyl Aliu- shumë vërejtje dhe sugjerime u dhanë nga parafolësit e tjerë, por unë po i përmendi vetëm një rast ku kam hasur në dy kode të cilat kanë emërtim të njëjtë.

Është kodi 14410 për shpenzime për vendime të gjykatave dhe është kodi 34000 përsëri thotë kodi për pagesat e vendimeve të gjykatave. Mua më intereson pse është i njëjti emërtim, kurse pagesa është bërë në dy kode?

Vërejtja e dytë është se diku kam hasur se ka shpenzime për informim publik, mirëpo nëse e hapim veb faqen e Komunës vërehet se nuk ka ndryshim asgjë. Informacioni i fundit i cili është për drejtorin e Urbanizmit, Naser Sylejmani i cili ka dhënë dorëheqje, të cilën dorëheqje e miraton kryetari i Komunës e cila është e postuar me 30.3.2001. Do të thotë veb faqja nuk është freskuar me asnjë lajm tjetër, por unë kam hyrë edhe në faqen e re, por e njëjta është edhe aty. Nga kjo shihet se asnjë informacion nuk mund të nxirret.

Nevzad Rushiti- sipas këtij raporti, të gjithë këshilltarët e grupeve politike nuk janë të kënaqur me të hyrat që janë realizuar këtë vit nga Drejtoria e Financave. Po shihet në bazë të raportit kemi rënie të të hyrave në Komunë, por përkundër asaj kemi shpenzime mjaft të mëdha në disa drejtori të cilat t sipas meje nuk kanë arsyetim.

Në tërë raportin për të dëshiruar është vetëm Kuvendi, sepse ne nuk harxhojmë asgjë me përjashtim ato paga të vogla të cilat i marrim, kurse shpenzime të tjera nuk kemi.

Për mua si këshilltar komunal ka harxhime të mëdha te Vala 900, mbi 30 mijë euro, kurse telefonat fikse 11 mijë euro. Unë mendoj se shumë shërbime mund të kryhen me telefoni fikse, kurse telefonat celular kanë një shpenzim jashtëzakonisht të lartë.

Gjithashtu u përmenden edhe shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit, të cilat drejtori i ka ndarë në shumë kode, por në tërësi janë 77 mijë euro, prandaj është mirë të na thuhet se kush ku ka udhëtuar dhe cili ka qenë qëllimi i udhëtimit.

Edhe për gjykatë shpenzimet janë ndarë në tri kode, është mirë të na thuhet saktësisht pse janë dhënë ato mjete në gjykatë.

Unë po them diçka edhe për investimet dhe po theksoj se ky mandat nuk e ka dhënë asnjë cent në nëndegën e V në Dheun e Bardhë.

Në Dheun e Bardhë në mandatin e kaluar janë bërë disa investime, por ato kanë mbetur në gjysmë për të cilat projekte vazhdimisht kemi kërkuar që të përfundojnë

Vjollcë Matoshi- unë do të koncentrohem më tepër për shkollimin e fëmijëve parashkollor, aty ku unë punoj dhe ku fillojnë hapat e parë të arsimit institucional të fëmijëve. Në raport është një kod ku thuhet për çerdhe dhe fëmijë parashkollor, për të cilin rast unë kam pyetje se ku po shpenzohen këto mjete, sepse nëpër shkolla nuk epet asnjë cent për këtë nivel të arsimit (parashkollor). Gjithçka që bëjmë ne aty e bëjmë me vullnetin e prindërve. Në raport thuhet shpenzimet për parashkollor dhe çerdhe, por kur ne kërkojmë në drejtori nuk ka asnjë cent të dedikuar për nivelin tonë shkollor. Unë edhe para tri viteve, DA-së iu kam drejtuar në këtë Kuvend dhe kam kërkuar së paku inventar për shkolla, por kjo kërkesë nuk është realizuar. Mua kjo po më brengos, sepse ne kërkojmë diçka nuk ka mundësi që ta marrim asnjë letër të bardhë, kurse në anën tjetër thuhet se ka mjete. Në kërkojmë një përgjigje së bashku me kolegët e mia pse deri më tash nuk është përfill asnjë kërkesë e jona?

Ejup Haziri- ne si grup i këshilltarëve të PDK-së e mbështesim raportin, mirëpo po e jap një sugjerim në raport me rënien e pagesës së taksës. Do të ishte mirë që të formohet një komision i cili do të ketë punë pak më tepër i cili do ta bëjë një regjistër me emra të pronarëve të automjeteve dhe të shihet dhe të bindemi se ku qëndron problemi, të gjendet e vërteta? Të shihet se cila hapësirë po shfrytëzohet, sepse numri i automjeteve është në rënie, kurse kushtin që ia kemi vënë ne qytetarë nuk i ka arrit rezultatet që ne i kemi pritur. Ka mundësi ta bëjë këtë një komision me një marrëveshje mirëkuptimi që të hulumtohet ky rast.

Sami Hoxah- unë do të ndërlihem vetëm te një rast lidhur me investimet kapitale të cilat po përmenden dhe po kërkohet të dimë kemi investime të tilla apo nuk kemi?

Lidhur me ato që na vijnë nga qendra është mirë që të angazhohemi edhe pozita dhe opozita, bile opozita për ta dëshmuar veten duhet të bëjë përpjekjeje për të bërë

investime në Gjilan, t' i tregojë fuqitë e veta dhe në këtë mënyrë mund të kenë përftime politike.

Në anën tjetër po ndërlidhem te çështja e parashkollorëve, sepse vitin e kaluar kam qenë zyrtar në DA për nivelin parashkollor. Nuk qëndron ajo që nuk kemi bërë investim në këtë nivel, por po t' i thuhet dikujt se kemi blerë lodra për fëmijë, ndoshta dikujt i duket shaka. Mirëpo për mua kjo ka qenë shumë me rëndësi, sepse qysh në atë institucion parashkollor fillon krijimi i personalitetit të fëmijës dhe i kam kushtuar shumë rëndësi këtij niveli shkollor në konsultim me drejtoreshat e institucioneve me edukatorët dhe kam kërkuar kërkesa nga ana e tyre. Unë me një ekip të ngushtë e kam hartuar listën e atyre kërkesave dhe kemi ndarë mjete për lodra didaktike të cilat për herë të parë në Komunën tonë i kemi blerë në mënyrë të organizuar.

Vlera e atyre lodrave që janë blerë ka qenë mbi 9 mijë e 600 euro dhe çdo institucion parashkollor është pajisur në mënyrë të barabartë. Kjo ka qenë një punë shumë e pëlqyeshme për të gjitha edukatorët të cilat kanë punuar në ato nivele.

Mirëpo drejtoreshat duhet t' i paraqesin kërkesat në DA, kurse ne do t' i analizojmë dhe nuk do ta lemë keq atë nivel arsimor, sepse është nivel i bazë i formimit të personalitetit të fëmijës.

Shefik Sudulli- për mua është brengosëse që një numër i këshilltarëve komunal ende nuk ka aftësi për ta përdorur teknologjinë informative. Për periudhën për të cilën bëhet fjalë, duhet ta dinë të gjithë se KK i Gjilanit ka një veb sajd të ri zyrtar e cila adresë është: [kk.rks – gov.net/gjilan](http://kk.rks-gov.net/gjilan) dhe ajo për të cilën bëhet fjalë është adresë e vjetër dhe nuk funksionon që nga viti 2010. Duhet të shfrytëzohet faqja e re, sepse aty së paku plasohen dy deri në tri informacione ditore.

Nuhi Nuhiu- unë sot do të mundohem ta sqaroj çdo shpenzim që është bërë në Komunë, prandaj nuk është mirë të bëhen pyetjet nga disa anëtarë të Kuvendit, kurse kur unë e marrë fjalën për të dhënë sqarime ata dalin jashtë.

Z. Zijadini pyet për të hyrat vetanake dhe sipas tij janë realizuar 73%, kurse sipas neve 93%. Ne planifikimin e kemi 3 milion e 600 mijë euro, por ne e kemi ndarë për muaj dhe për këtë arsyeje ai rezultat është si 73% nëse e merr totalin si 93% nëse e marrim për nëntë mujor. Te pagat është tetë mujori nuk është nëntë mujori.

Gjithashtu po thuhet se do të kemi shumë obligime të cilat do të na mbesin, por tash Qeveria na i ka ndarë edhe 450 mijë euro për mbulimin e shpenzimeve të mallrat dhe shërbimet dhe komunalit në të gjitha kategoritë e shpenzimeve. Mirëpo me të hyra vetanake ne 1 milion euro do t' i kemi në buxhetin e Komunës sonë.

Për gjrobat në trafik planifikimi ka qenë real, por ka ndryshuar ligji për gjoba në trafik dhe ne këtë nuk e kemi ditur. Për këtë arsye ne në vitin 2013 e kemi bërë një planifikim krejt tjetër në krahasim me vitin 2012.

Drejtori i Financave filloi për t' i sqaruar të gjitha shpenzimet në bazë analitike duke sqaruar secilin shpenzim me emër dhe mbiemër se kush ka udhëtuar jashtë vendit dhe sa ka shpenzuar, duke vazhduar në këtë mënyrë për secilin kod.

Izmi Zeka – kush është për aprovim të raportit financiar?

Aprovohet pika 2 e rendit të punës: Raporti financiar nëntë mujor 2012, me 20 vota të anëtarëve të Kuvendit, 13 ishin kundër, kurse 5 abstenuan.

2/2. Propozim-vendimi për lejimin e transferit dhe harmonizimit të mjeteve financiare

Izmi Zeka- për këtë pikë përsëri e lus drejtorin e financave të na jep sqarime.

Nuhi Nuhiu- tash është përfundimi i vitit buxhetor dhe dy muajt e fundit kemi probleme me pagat e punëtorëve të shërbimit civil, mirëpo kemi mjete të cilat e mbulojnë këtë minus nëpër disa drejtori. Për këtë arsyeje duhet të bëhet transferi prej një drejtorie në drejtorinë tjetër. Mirëpo Ligji mbi financa nuk lejon që të bëhet ky transfer për pa u aprovuar në seancë të Kuvendit. Duhet Kuvendit për ta marrë një vendim dhe brenda një muaji ta harmonizojmë këtë, sepse nuk është problem i mungesës së mjeteve.

Izmi Zeka- kush është për aprovim të kësaj pike të rendit të punës?

Aprovohet pika 2/2 e rendit të punës: Propozim-vendimi për lejimin e transferit dhe harmonizimit të mjeteve financiare, me 24 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 3 ishin kundër

2/3. Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për raste sociale,

Sali Fazliu- z. Fazliu dha sqarime para anëtarëve të Kuvendit, por ato sqarime të gjithë anëtarët e Kuvendit i kanë me shkrim në materialin e seancës.

Izmi Zeka- kjo çështje është mjaft e njohur dhe e kemi debatuar disa herë, prandaj besoj se nuk është e nevojshme ta elaborojmë më shumë, sepse edhe para dy-tri seancave kemi biseduar për këtë temë.

Nevzad Rushiti- sipas meje, zyrtari i Drejtorisë së Kadasrtrit nuk ka qenë desh të jap asnjë arsyetim, por ka qenë desh të thotë se ka përfunduar kjo punë dhe janë ndërtuar shtëpitë. Kjo pikë ka qenë edhe më parë dhe atëherë ne kemi dhënë vërejtje se kjo nuk ka i kaluar procedurat e nevojshme për të ardhur në Kuvend. Është thënë se ka donatorë dhe arsyetime të tjera, por duhet ta dinë të gjithë këshilltarët komunal se atje shtëpitë janë ndërtuar dhe i gëzofshin ata njerëz ato shtëpi, por sipas meje janë shkelur procedurat dhe rregullat.

Në Kuvend ne kemi theksuar pas rastit të ish komandantit Shefket Musliu, prona komunale mos të ndahet dhe prona publike të ruhet për nevoja të tjera.

Për mua më mirë do të ishte që në atë vend më mirë do të kishte qenë që të bëhen dy-tri objekte kolektive se sa është bërë kështu. Më mirë të zgjidhet problemi për shumë familje, sepse në këtë formë janë shkelur rregullat dhe procedurat.

Izmi Zeka- është ajo kryesorja se këtu është bërë një punë e mirë, sepse ia kemi zgjidh problemin e banimit dy-tri familjeve. Ju këshilltarët komunal para disa seancave nuk e keni miratuar një propozim për t'iu ndihmuar disa qytetarëve të cilët në ekstrem janë skamnor. Ne tash ia kemi ndërtuar dhe bile ia kemi uruar.

Qemajl Mustafa- duhet sqaruar se ka qenë një periudhë specifike, sepse donatorët kanë pas ardhur (një bashkim i donatorëve) dhe qëllimi tyre ka qenë për t'iu ndihmuar dy familjeve skamnore. Për këtë arsyeje unë e kam ngutur dhe në kohën e duhur e kemi sjell në Kuvend. Për shkak të neglizhencës së një zyrtari, sepse atëherë nuk ka qenë drejtoresha ka qenë desh t'iu shpjegohet për çka është fjala (unë jam edhe vetë kritik). Për mungesë të informacioneve ka pasur keqkuptime dhe ju nuk e keni votuar. Përndryshe ende për pa u heq asnjë lopatë dhe prej atij lokacioni ne e kemi proceduar. Mirëpo po të ndaleshim aty i kishim humbur dy shtëpi dhe ajo është një tokë afër një gremine, pranë një moçalishte dhe nuk i shërben askujt. Ajo pjesë ka qenë e stërkequr ka pasur mbeturina të gjuajtura aty dhe është menduar që një rrip toke të destinohet për këtë aspekt. Duhet ditur se janë ndarë 4 troje nga 2 ari, ndërsa 700 metra të tjera ku zgjerohet pak toka i kemi lënë për një banim kolektiv. Aty do të jetë një ndërtesë me disa banesa gjithashtu për banim social. Toka mbetet pronë e Komunës, por dhe ndërtesat mbesin pronë e Komunës, kurse familjet skamnore jetojnë aty bazuar në ligjin e akteve nën ligjore për banim social. Ata janë me kontratë aty për derisa janë raste sociale dhe në momentin kur i krijohen kushtet, ata e humbin të drejtën e banimit. Është e vërtetë se ka ndodhur një tejkalim procedural, por ka ndodhur për shkak të mosnjohjes së problemit kur ju nuk e keni votuar.

Sokol Haziri- kur bëhet fjalë për këtë kategori të njerëzve, më së paku duhet të zgjasim debate. Ne mund të bisedojmë gjatë dhe njerëzit të hyjnë në dimër pa kulm mbi kokë, është e pakuptimtë. Mirëpo jam për atë që të respektohet maksimalisht procedura dhe prona publike të ruhet, por nëse ka mbetur prona publike të ruhet te këta skamnorë, unë definitivisht nuk jam për ta ruajtur. Këta janë banorë të këtij vendi dhe i duhet dhe e meritojnë një kulm mbi kokë. Unë jam për t'iu respektuar procedurat, por donatori nuk i dinë procedurat tona, prandaj mos të humbim kohë në këtë çështje. Mirëpo Komuna dhe kryetari në këtë çështje duhet të ketë konsideratën maksimale për këtë kategori dhe t'iu gjendet zgjidhje të gjithëve.

Ejup Haziri- sigurisht që nuk është kundër askush kundër kësaj kategorie, por ne kemi nevojë për një informacion shtesë për ta ditur raste sociale se cilat janë? Duhet të dihet se për kënd bëhet fjalë që vendoset aty për të mos pasur asnjë dilemë?

Qemajl Muatafa- ne e kemi një komision i cili punon me vite të tëra, ai komision ka qenë gjatë tërë mandatit të kaluar dhe ka punuar me autoritetin e Kuvendit. Në ndërkohë e kemi reduktuar përsëri e miratimin të Kuvendit dhe janë tre njerëz (Sadri Arifi, Ibrahim Salihu, Samiu Ahmeti) të cilët kanë një listë së paku prej 300 familjeve me gjendje ekstreme të rëndë. Këta dy skamnorë të cilët i kanë gjet vet donatorët (këta i kanë identifikuar vetë donatorët jo ne), por edhe këta janë pjesë e listës dhe me rëndësi është shumë që dy raste i kemi zgjidh. Një rast është në Zabel në përfundim e sipër i cili është donacion i kompanisë dhe po të njëjtit e kanë blerë edhe

një shtëpi në qytet dhe në këtë mënyrë i kemi 4 raste të zgjidhura. Unë jam që ligji dhe procedura të respektohet maksimalisht, por ju duhet të na kuptoni në këto raste.

Unë po pyes a më mirë do të ishte mos ta marrim këtë donacion dhe t' i ishin dekorajuar këta donatorë, por edhe familjet skamnore. Ne kemi bërë një tejkallim procedural, por shtëpitë janë aty!

Sabedin Kadriu- unë çdo cm tokë të Porodinit e njoh përmendësh, sepse aty i kam ruajtur bagëtinë kur kam qenë fëmijë. Mirëpo ka pyetje se është fshehtësi për ta ditur se cilat familje i kanë përfituar ato shtëpi? Të thuhet emri dhe mbiemri x dhe y e kanë fituar të drejtën për këtë? Unë dua ta di për ke po votoj?

Abdyl Aliu- unë fillimisht e shprehi një shqetësim që nuk mu dha fjala për të reaguar në një përgjigje e cila m' u adresuar mua.

Lidhur me këtë propozim për dhënie në shfrytëzim të pronës Komunale iu dha një qasje e gabuar fjalës së anëtarit tonë nga LDK.. Ne si LDK e vlerësojmë qëllimin e mirë dhe fisnik të dhuruesit të propozimit të dhënies së pronës komunale për raste sociale.

Mirëpo mënyra se si mendohet të bëhet kjo, ose më mirë të themi se si është bërë kjo është krejtësisht e gabuar dhe është në dëm të Komunës së Gjilanit, është në dëm të gjeneratave të ardhshme, por edhe në dëm të atyre që po mendohet t' i ndihmohet në këtë rast. Ne mendojmë se qëllimin e mirë të këtij dhuruesi duhet ta mbështesim të gjithë, por atë duhet ta materializojmë në një mënyrë tjetër. Ne të gjithë dëshirojmë që të mos kemi fare raste sociale. Mirëpo nëse ne vetëm i japim dikujt tokë dhe i themi veproni si të doni aty, kjo nuk qëndron dhe nuk është në rregull! Këtë qëllim fisnik ne mund ta materializojmë shumë lehtë, sepse ne tash i kemi dy raste të PPP-së të cilat edhe janë para përfundimit. Pjesa që i takon Komunës nga ky partneritet është shumë më i madh se 5 banesa dhe dikush mund ta dijë edhe saktë sa banesa i takojnë Komunës nga PPP. Unë bëj pyetjen, pse ato banesa nuk ndahen për raste sociale, pasi që ato banesa janë të Komunës. Komuna e ka për obligim që të punojë për mirëqenie të qytetarëve dhe nuk e di se a ka mënyrë më të mirë se në këtë formë t' i ndihmohet rasteve sociale. Pajtohemi të gjithë që atë pjesë ta ndajmë për raste sociale, por ajo duhet të planifikohet mirë dhe të inkorporohet në Plan rregullues urban dhe të bëhet një arkitekturë e pëlqyeshme e jo në këtë formë. Prej asaj parcele prej 1500 m², vendosen 5 familje, mirëpo me kushtet tekniko-urbanistike aty do të kishte mundësi të ndërtohet një objekt me afër 6 mijë m² banim dhe do të ishte një zgjidhje më e mirë që është bërë tash. Në një seancë të kaluar kolegu i ynë Arben Maliqi ka kërkuar rrugë me 4 korsi në atë pjesë të qytetit dhe në pjesë të tjera të qytetit e të cilin propozim ne përkrahim të gjithë dhe të gjithë duhet të kemi aso rrugë. Mirëpo rruga me 4 korsi dhe ato shtëpi me atë arkitekturë askush nuk do ta pëlqejë atë pamje.

Ne si LDK jemi që të ndërprehet kjo praktikë dhe t' themi jo këtyre rasteve ! Po e them një fjalë bukur të rëndë, por kjo është kontrabandë me pronën komunale.

Sadri Arifi- unë do t' i them edhe emrat, por e them edhe një detal, sepse pos këtyre dy familjeve që kanë gjetur dhurues , i kemi edhe 4-5 familje të tjera të cilat kanë gjetur dhuruese, por në mungesë të hapësirës dhe të pronës ata presin përgjigje nga ky

Kuvend. Për këtë arsyeje unë mendoj se aprovimi i këtij vendimi do të ishte shumë i mirë edhe për të tjerët që presin që t' i ndahet pronë.

Në këtë rast është fjala për familjen e Hasan Bektshit, nga Rekalitë e cila familje ka pozitë shumë të rëndë. E dyta është familja e Mirvete Jasharit e cila më parë ka jetuar në Kodër të Përlepnicës e cila gjithashtu është në varfëri të skajshme. Duhet ditur se këto dy familje i kanë gjetur dhuruesit vetë.

Elisah Ymeri- unë vetëm dua ta përshëndes këtë nismë të kryetarit të Komunës, sepse kjo është shumë humane dhe njerëzore. Mirëpo edhe unë jam për t' i respektuar procedurat dhe ndoshta do të kisha ngrit dilemat për ta miratuar apo jo? Mirëpo ne po bëjmë fjalë, kurse ato familje janë vendos në shtëpia, vëne dorën në zemër dhe votoni! T' i llogojmë ata fëmijë prej shtëpisë, apo t' i lëmë aty? Vetëm këtë mendojeni! Kryetarin e Komunës në veçanti e falënderoj për këtë angazhim, sepse kjo është shumë humane dhe njerëzore. A ka më njerëzore se dikujt në këtë dimër t' ia sigurosh kulmin mbi kokë?

Sami Hoxha- unë desha ta bëj në sqarim dhe ta bëjë një krahasim me seancën kur e kemi refuzuar këtë rast, sepse atëherë ka pasur mos kuptim apo nuk është sqaruar si duhet, sepse këtu ka qenë bindja se ajo tokë po iu ndahet dy familjeve të cilat e kanë gjetur dhuruesin dhe ajo pronë po kalon në pronësi të tyre.

Sot është kjo shumë mirë e sqaruar se ajo është tokë e Komunës, janë ndërtuar dy banesa janë gjetur donatorët dhe familjet janë në listën e Komisionit i cili i ka vizituar dhe janë në evidencë si raste të rënda sociale. Pronësia e atyre objekteve është e Komunës për të cilin rast e sqaroi mirë kryetari.

Ne kemi bërë një krahasim me ato raste e mëparshme të Tregu i Rërës, por këto krahasime tash nuk kanë asgjë të përbashkëta në mes veti. Atje ajo pronë është ndarë në emër të individit dhe iu ka dhënë për arsyeje të ndryshme, kurse këtu është pronë e Komunës. Në këtë rast ndoshta janë tejkaluar disa procedura, por herëve të tjera i bëjmë me kohë dhe i sqarojmë mirë. Unë mendoj se këtë rast duhet ta aprovojmë, kurse për të ardhmen duhet ta sqarojmë mirë çdo rast dhe mos të lëmë hapësirë dhe dilema.

Florinë Zymberi – unë këtë rast në cilësinë e arkitektes e kam kaluar në Komitet të Urbanizmit për pa e ditur as emrin dhe mbiemrin dhe për pa e ditur se kush e ka bërë kërkesën. Unë vetëm në aspektin urbanistik e kam parë që është e nevojshme dhe është ditë pronësia dhe ka qenë e njohur se është pronë e Komunës dhe çdo gjë ka qenë e ditur dhe është harmonizuar me Planin rregullues urban.

Izmi Zeka- kush është për aprovim të kësaj pike të rendit të punës?

Aprovohet pika 2/3 e rendit të punës: Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për raste sociale, me 20 vota të anëtarëve të kuvendit, kurse 12 ishin kundër

2/4. Propozim vendimi për uljen e tarifës mbi qiranë për shfrytëzimin e lokalit afarist (Bodrumi-Tombola) në Gjilan

Izmi Zeka- lidhur me këtë pikë të rendit të punës, kryesuesi ia jep fjalën Behar Mehmetit, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike.

Behar Mehmeti- në këtë vend është një hapësirë mbi 100² e cila dedikohet aktivitetit, në këtë rast aktivitetit sportiv dhe ne jemi të gjithë për t' i ndihmuar sportit dhe tarifa e cila është aprovuar për këtë vit për vitin 2012 është e papërballueshme për një aktivitet të tillë. Kjo është një hapësirë e cila edhe nuk është shumë profitabile, prandaj unë mendoj se Kuvendi sot e kupton rastin dhe mendoj se do të gjejë përkrahje tek ju.

Arben Mehmeti- unë po filloj prej asaj që e tha drejtori se me këtë propozim-vendim i ndihmohet sportit. Mirëpo unë aty e di se është prognozë sportive, prandaj po pyes a jemi ne si Kuvend për t' i ndihmuar prognozës sportive dhe bastoreve?

Mandej ka pyetje se e kujt është ajo bastore dhe ai i kryen obligimet në raport me Komunën, a i kryen obligimet komunale. Unë kërkoj sqarim zyrtar këtu ? Kush është pronari dhe cili është raporti i tij me Komunën?

Mandej nuk e kam të qartë, sepse këtu thuhet i epet Klubit “Drita”, mirëpo unë e di sigurt se atë e kontrollon tjetërkush dhe e menaxhon. Për mua është shumë e paqartë kjo dhe nuk habitem, sepse po shihen vendimet e kaluara që janë për t' i habitur, por kjo tash më është standard dhe “rregull”. Nuk është në rregull të bëhet privatizim i këtij lokali nga një klub sportiv, nuk është në rregull kur Gjilani ka edhe shumë klube të tjera. Ne si LDK jemi për t' i ndihmuar klubet sportive, por në këtë formë si na adresohen neve është shumë e papranueshme.

Izmi Zeka- një sqarim duhet dhënë këtu! Duhet të jetë klubi sportiv KF “Drita” dhe “Gjilani” dhe jo vetëm njëri. Do të thotë shfrytëzohet nga të dy klubet dhe ulet kjo ngarkesë.

Arben Maliqi- unë në parim pajtohem me homologun tim, sepse ka të drejtë në disa gjëra. Ne nuk duhet të harrojmë se në Komunën e Gjilanit nuk janë vetëm dy klube, por 30 klube me 3 mijë deri në 5 mijë sportistë. Unë iu lus mos të bëjmë diskriminime, sepse nuk janë në Gjilan vetëm KF “Drita” dhe “Gjilani”, por janë 30 klube. Për këtë arsyeje propozoj t' i marrim klubet të cilat janë në super ligë dhe ta bëjmë një financim të tillë. Edhe unë nuk e kam të qartë se kush po e menaxhon dhe nën patronatin e kujt është ky lokal? Ky lokal duhet të jetë nën patronatin e DKRS-së dhe jo t' ia japim njerëzve dhe ata të kenë përfitime të veta. Unë kërkoj sqarim shtesë.

Behar Mehmeti- ne e dimë të gjithë se ai lokal është ish Klubi “ Crvena Zvezada” dhe tash faktikisht është e njëjta hapësirë dhe i njëjti lokal, prandaj për këtë arsye është bërë destinimi për klubet sportive. Unë nuk jam i thirrur për të hyrë në detale për të dhënë sqarime a është komercial dhe sa është komercial? Kush e menaxhon dhe kujt i destinohet etj? Kjo ka qenë në kuadër të Sektorit të Banimi i cili sektor ka kaluar në Drejtorinë për Shërbime Publike vitin e kaluar, prandaj unë e kam pranuar si të trashëguar. Unë po pajtohem se si hapësirë duhet t' i shërbejë të gjitha klubeve

sportive, sepse të gjitha klubet sportive janë të Komunës sonë dhe unë jam për atë që të miratohet, por megjithatë të ekziston taksa si ka qenë paraprakisht 1.8 euro për m², por faktikisht ai profit i cili bëhet përmes asaj tombole le të shpërndahet proporcionalisht duke miratuar një skemë të shpërndarje si Kuvend, apo një komisioni i cili duhet të formohet ose DKRS ose prej Kuvendit dhe ta bënë shpërndarjen e mjeteve proporcionalisht nëpër klube. Unë jam për atë që kjo hapësirë e cila zhvillon një aktivitet në podrum nuk ka ndonjë profit për ta ngarkuar ne me tarifën ekzistuese prej 40% e që i bie diku 12 euro.

Izmi Zeka- pasi që DKRS ta merr në menaxhim këtë lokal nga viti 2013, ajo është e detyruar ta sjell ndonjë rregullore për menaxhim të këtij lokali afarist. Ne sot po propozojmë vetëm për tas ul tarifën për t' i krijuar parakushte për të funksionuar, kurse më 2013 drejtorja e bie një rregullore të veçantë si duhet të funksionojë ky lokal?

Qemajl Mustafa- së pari duhet të merremi vesh që ai që e shfrytëzon lokalin është OJQ. Ajo organizatë është jo përfituese dhe nëse punojnë aty dy njerëz ata i mbulojnë të ardhurat e veta, por dhe nëse punojnë 4 gjithashtu i mbulojnë rrogat e veta, por profit nuk guxojnë për të pasur. Me kontratë specifikohet saktë që profiti paguhet për Komunë dhe destinohet për futbollin. Mos të ekzagjerohet, sepse aq shumë kemi klube sportive dhe aq shumë kemi kërkesa sa që kurrë KK, nuk do t' ia del të gjitha klubet për t' i financuar. Mirëpo pasi që tradicionalisht e ka shfrytëzuar KF "Drita", le t' i mbetet futbollit, sepse ato janë të ardhura shumë të vogla dhe ne jemi të obliguar si institucion të krijojmë kushte infrastrukturore për sportin. Ne nuk mund t' i mbajmë klubet, nuk mundemi, sepse nuk kemi buxhet. Klubet mbahen në këtë mënyrë dhe me dhurues të ndryshëm, por edhe nëse bëhet ndonjë ligj i mirë mund edhe të privatizohen ose bëhen shoqëri aksionare etj. Mirëpo ne e kemi për detyrë stadiumet për t' i rregulluar dhe mirëmbajt, sallat sportive dhe terrenet sportive për t' i mirëmbajt, por edhe për të krijuar edhe të reja. Kjo është detyra e jonë. Mirëpo e vetmja Komunë jemi në Kosovë që harxhojmë dhjetëra, mijëra euro në vit për transport të futbollistëve. Të jeni të bindur se këtë nuk e kanë të tjerët. Opozita shpesh po na kritikon pse ka shumë shpenzime, por ato kanë ndodhur, sepse ne nganjëherë kemi shkuar edhe përtej mundësisë që i kemi financiarisht me qëllim që t' i shërbejmë më së miri qytetarëve.

Sadudin Berisha- ne po flasin diçka, kurse në anën tjetër po veprojmë krejt diçka tjetër! Në çastin kur thuhet se tarifa, qiraja për 1 m² zvogëlohet për një sasi, përsëri kemi të bëjmë me qira! Në këtë mënyrë qiramarrësi identifikohet me titullin e firmës dhe në këtë drejtim kemi konflikt interesi. Në njërin anë japim lokalin me qira dhe në anën tjetër përpiqemi të diktojmë politikë të mënyrës së shfrytëzimit të asaj hapësire.

Së dyti nëse epet me qira duhet të shpallet ankand për t' i ofruar kërkesat, atyre që janë të interesuar për ta marrë. Mund të specifikohet vlen ankandi vetëm për klubet sportive. Kjo nuk ka ndodh në asnjërën mënyrë, kurse në anën tjetër nuk guxojmë të vazhdojmë me trashëgimi që ta shfrytëzojë ai klub që ka qenë aty. Ne kujtojmë se duhet patjetër t' ndihmojmë klubet sportive, mandej qiraja fare nuk duhet të ekzistojë për shfrytëzimin e asaj hapësire nga klubet sportive. Mund të specifikohet me përparësi për klubet sportive të futbollit për shkak të masivitetit më të madh. Mirëpo të epet me qira

e cila qira sado të jetë e vogël, prapë është me qira. Mandej t' i diktosh politikat e afarizmit dhe mënyrës së shfrytëzimit është e papranueshme dhe është kundër ligjit. Për këtë arsye kujtoj se duhet të qartësohet se kjo hapësirë duhet t' i epet DKRS-së dhe ajo duhet ta menaxhojë në marrëveshje me klubet. DKRS të nxjerr një rregullore dhe të shfrytëzohet. Kjo mënyrë si po bëhet është thjeshtë është mundësia e dhënies së një grupimi të caktuar për ta menaxhuar në mënyrë të tyre si dëshirojnë dhe krejtësisht në kundërshtim me ligjin.

Arben Mehmeti- drejtori për Shërbime Publike e tha më tepër privatisht dhe nuk e sqaroi si duhet. Prandaj pyetje për drejtorin e Financave se kjo firma e cila është duke e menaxhuar atë objekt a është taksapaguese e Komunës ?

Mandej kryetari e tha se është OJQ, unë nuk e kam të qartë dhe ndoshta këtë rast mund të gabo, por tombola të konsiderohet si OJQ për mua është e papranueshme. Këtu ka mjaft paqartësi dhe nëse nuk gabo, kjo ka qenë edhe objekt i hetimeve për shkak të keq menaxhimit. Ky lokal duhet t' i kthehet në menaxhim DKRS-së.

Nuhi Nuhiu- atë lokal e menaxhon një OJQ e cila nuk paguan taksë komunale, taksë biznesi, kurse qiranë është e obliguar ta paguajë. Do të thotë taksë për biznes nuk ka!

Behar Mehmeti- kontrata mbi qiranë ekziston të cilën e ka përpiluar Sektori i Banimit i cili ka operuar deri në qershor të vitit të kaluar. Ky sektor ka qenë kuadër të Drejtorisë së Gjeodezisë i cili tash është transferuar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

Kontratat janë për të gjitha hapësirat dhe lokalet të cilat janë pronë e Komunës.

Leonorë Bunjkau- në emër të grupit tim dhe në emër të disa qytetarëve të cilët janë qiramarrës të lokaleve të Komunës së Gjilanit e kam për obligim për ta përcjell kërkesën e tyre. Mirëpo ne dhe si grup jemi për ulje të tarifës, kur është fjala edhe për tombolë, edhe pse aty shkojnë njerëzit dhe kërkojnë argëtim, por edhe shumë herë dalin me xhepa të zbrazët. Mirëpo duhet t' i kemi në konsideratë jo vetëm sportin dhe rininë, por t' i kemi në konsideratë edhe qytetarët e tjerë të cilët në këtë rast janë simbolikë. Unë edhe më parë e dëgjova kryetarin i cili theksoi se jemi në vazhden e një korrigjimi të taksave dhe kompensimit të qirasë, kërkoj që t' i kemi në konsideratë të gjithë. Jo të shkojmë në ngritje të qirasë 100%, por edhe atyre t' i bëhet një lehtësim edhe për qytetarët dhe jo vetëm ata që merren me sport.

Qemajl Mustafa- me sa e di unë, ne i kemi 12 lokale, te njëra hapësirë obligimi i qiramarrësit ka arrit në 57 mijë euro. Unë jam befasuar kur e kam marrë këtë informacion para një muaji. Për këtë rast kam formuar komision të veçantë, kurse lëndën e kanë proceduar Sektori i Banimit në Gjykatë, por nuk ka marrë masa administrative askush, sepse nuk ka ardhur tek unë për të iniciuar që unë të ndërmarra masa administrative për ta larguar këtë qiramarrës prej asaj hapësire.

Institucioni i Komunës ka qenë desh atij t' ia ndërpresë kontratën dhe të tentojë me gjegjë t' ia marrë qiranë. Një gjë e tillë nuk është bërë, por gjithashtu nuk është ndërmarra asgjë edhe ndaj zyrtarëve të cilët e kanë lejuar atë gjendje. Mirëpo tash unë jam në proces lidhur me këtë, sepse përkundër qirasë skajshmërisht të ulët për m² e cila

ka qenë 6 euro për m². Këtu kemi një keqpërdorim të madh tek të hyrave, por jo vetëm të kësaj, por edhe 1 ose 2 raste të tjera, me prolongime dhe vonesa të pagesave etj.

Nuk mund të bëjmë tolerime të tilla. Unë i kam pasur qiramarrësit në zyrën time edhe atë disa herë dhe iu kam thënë herën e fundit, le të jenë lokalet e juaja, po iu pyes juve për sa para ju i kishit lëshuar me qira ato lokale? E vërteta është se nuk i kishin dhënë nën 20 euro për m². Si po kërkon nga Komuna kjo qira të jetë nën 20 euro?

Do të thotë kemi të bëjmë me hapësira në zonën I (një) në qendër të qytetit. Mirëpo përsëri thuhet se ia kemi ngrit shumë qiranë, bile edhe ndonjë këshilltar se ia kemi ngrit shumë qiranë 100%. Kjo nuk qëndron, sepse e kanë pasur qiranë skajshmërisht ulët 6 euro për m². Askush nuk thotë se ka qenë tepër ulët dhe në dëm të Komunës me vite të tëra, por thotë e keni rrit shumë qiranë! Ne e kemi formuar një komision i cili ka konstatuar se askund nuk ka çmim më të ulët dhe janë deklaruar se ne simbolikisht mund ta bëjmë qiranë 18 euro për m², sepse këto janë çmimet. Ju lus që mos t'ekzagjerojmë gjërat, sepse duhet respektuar rregullat e tregut.

Izmi Zeka- të deklaroheni se kush është për aprovim të kësaj pike të rendit të punës?

Aprovohet pika 2/4 e rendit të punës: Propozim vendimi për uljen e tarifës mbi qiranë për shfrytëzimin e lokalit afarist (Bodrumi-Tombola) në Gjiilan, me 19 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 14 ishin kundër.

Me këto pika të rendit të punës në ora 13.10 min, seanca i përfundoi punimet, kurse kryesuesi i uron festën e 28 Nëntorit dhe të 100 Vjetorit të Pavarësi së Shqipërisë të gjithë këshilltarëve komunal dhe qytetarëve të Gjiilanit.

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

Izmi ZEKA